

**AKT – THEMELIMI I SHOQËRISË  
"BANCONOTE" SH.P.K**

Sot, me 23/01/2024, une, themeluese, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "Banconote" sh.p.k

Themeluesi i shoqërisë është:

- **Fjodor Meminaj**, i biri i Arben dhe Ylberë e datëlindjes 09.10.1994 lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë me adresë: Rruga e Kavajës Pallati Orion Shkalla 2 Ap 46, Tiranë, i pajisur me dokumentin e identitetit, ID, me Nr.Personal: J41009091Q madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, me cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë "Banconote" sh.p.k.

Ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" I ndryshuar dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 "Per Rregjistrimin e Biznesit", kam vendosur te themeloj nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar te emeruar "**Banconote**" sh.p.k.", duke nenshkruar kete Akt Themelimi. Aktiviteti i kesaj Shoqerie do te rregullohet nga Statuti i saj, i cili eshte pjese perberese e ketij Akti Themelimi.

**NENI 1  
EMËRIMI DHE LLOJI I SHOQËRISË**

Shoqëria e formuar do të emërohet "**Banconote**"sh.p.k dhe do të jetë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

**NENI 2  
SELIA E SHOQËRISË**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresë: Rruga Jordan Misja Nr Pasuris 8/507-N4, Tiranë.

**NENI 3**

**KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE EKONOMIKE**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pakufizuar.

**NENI 4**

**OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

Objekti i veprimtarisë ekonomike të shoqërisë "Banconote" sh.p.k është :

- Këmbim valuator dhe transfert parash, Agjent i Shoqërisë Easy Pay (Institucion i Parase Elektronike) për kryerjen e shërbimeve që përfshijnë por nuk kufizohen në pagesat faturash, shitje të mallrave/shërbimeve të partnerëve Easy Pay, Rimbushje elektronike etj.



**NENI 5**  
**KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË**

Kapitali fillestar i shoqërise do të jetë 2.500.000 ( Dy miljone e pese qind mije lekë ). Z. Fjodor Meminaj zotërues i 1 (një) kuote sa (100 % të kapitalit) të barabartë me vlerën nominale 2.500.000 (Dy milion e pese qine mije) leke.

Kapitali themeltarë zotërohet totalisht nga ortaku i vetëm Z.Fjodor Meminaj, shtetass Shqiptare, Lindur në Vlore dhe banuese në Tiranë, pajisur me dokumentin e identitetit, ID, me Nr.Personal: J41009091Q.

**NENI 6**  
**KONTRIBUTI I ORTAKEVE**

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë.

Ortakët mund të vendosin për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

**NENI 7**  
**KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të funksionojë me një afat kohor të pakufizuar. Afati i fillimit të veprimtarisë fillon pas regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit

**NENI 8**  
**ADMINISTRIMI I FITIMEVE**

Fitimi i realizuar kalon në pronësi të ortakut themelues.

Fitimi është lirisht i transferueshëm brenda dhe jashtë shtetit shqiptar.

**NENI 9**  
**ORGANET E SHOQËRISË**

Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga Administratori

1.Administratori

Mënyra e organizimit dhe funksionimit është përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Administratori i shoqërisë do të jetë :

- **Fjodor Meminaj**, i biri Arben dhe Ylberë e datëlindjes 09.10.1994 lindur në Vlore dhe banues në Tiranë me adresë: Rruga e Kavajes Pallati Orion Shkalla 2 Ap 46, Tirane, i pajisur me dokumentin e identitetit, ID, me Nr.Personal: J41009091Q madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, me cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë “Banconote” sh.p.k.



## **NENI 10**

### **TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKËVE**

Ortakët e shoqërisë janë të detyruar që të ruajnë sekretin e dokumentacionit dhe të informacionit si dhe eksperiencën e realizuar brenda kontekstit të shoqërisë dhe të evitojnë përhapjen e tyre qoftë dhe pjesërisht.

## **NENI 11**

### **MARDHËNIET E PUNËS**

Mardhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi. Shoqëria private merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për dëmet që i shkaktojnë kësaj shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

## **NENI 11**

### **KONFIDENCIALITETI**

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të bëhet publike përmbajtja e tyre për të tretët e të gjitha akteve dhe dokumentave që janë përcaktuar si të tilla nga administratorët e kësaj shoqërie.

## **NENI 13**

### **PJESËMARRJA NË SHOQËRI OSE AKTIVITETE TË TJERA**

Ortakët e shoqërisë nëpërmjet Asamblese së Përgjithshme mund të vendosin për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera, futjen e personave të tjerë si ortakë të shoqërisë dhe të krijojnë cdo lloj aktiviteti tjetër privat, por jo konkruet me atë të shoqërisë së themeluar prej tij.

## **NENI 14**

### **LIKUJDIMI I SHOQËRISË**

Nëse shoqëria do të likuidohet atëherë do të caktohet një komision likuidimi që do të parashtrijë një bilanc likuidimi për miratim.

## **NENI 15**

### **EKSPERTËT DHE REVIZORËT KONTABËL**

Kontrolli mbi veprimtarinë e Administratorit, si dhe gjithë aktivitetin e shoqërisë i besohet një eksperti ose revizor kontabël i caktuar nga asambleja. Ky ekspert do të qëndrojë në detyrë për atë sa përcaktohet me ligj dhe mund të rizgjidhet. Asambleja e Ortakëve cakton dhe shpërblimin përkatës kur nuk ka norma të vecanta ligjore.





**NENI 16**

**BILANCI DHE NDARJA E FITIMEVE**

Veprimtaria ekonomike vjetore e shoqërisë do të mbyllet në datën 31 Dhjetor të cdo viti. Administratori merr masa për hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventar. Pasi vecohen fondet si më sipër dhe paguhen detyrimet fiskale, të ardhurat që mbeten i kalojne ortakut te vetem dhe mund të transferohen lirisht jashtë shtetit sipas dispozitave përkatëse ligjore.

**NENI 17**

**LEGJISLACIONI I APLIKUESHEM**

Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet nga statuti i shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

**NENI 18**

**ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Gjykata kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**NENI 19**

**DISPOZITA TË FUNDIT**


Akti Themelimit është hartuar në 4 kopje origjinale në gjuhën Shqipe dhe nënshkruhet rregullisht nga ortakët e shoqërisë.

**O R T A K E T**

**E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

*“Banconote” sh.p.k*

**Fjodor Meminaj**

*Fjodor Meminaj* 

**Emri dhe Nënshkrimi**